



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
P-073
Prishtinë, më 22 shtator 2016

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 SHTATOR 2016

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Xhevahire Izmaqu, Besa Gaxherri, Visar Ymeri, Pal Lekaj, Slavko Simiq, Valdete Bajrami, Abdyl Ymeri, Njomza Emini, Aida Dërguti, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha dhe ministri Arsim Bajrami, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Pati edhe deputetë të tjerë që ishin lajmëruar, por koha e paraparë për deklarime jashtë rendit të ditës përfundoi. Ata deklarimet do t'i paraqesin në seancën e radhës, sipas radhitjes së paraqitur.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, lidhur me pagesat e pensioneve edhe pas vdekjes së pensionistëve. Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami lidhur me dërgimin e librave shkollorë për nxënësit shqiptarë në Luginën e Preshevës. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Raif Qela i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me procedimin e projektligjit për “Trepçën”. Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me pagesat e specializantëve shëndetësorë. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me mosfunksionimin e aparaturave mjekësore në shëndetësinë sekondare dhe terciare. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me mosfunksionimin e Odave të profesionistëve shëndetësorë. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Selvije Halimi i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, Imet Rrahmani, lidhur me përgaditjet për fillimin e implementimin e sigurimeve shëndetësore. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me procedimin e Projektligjit për arsimin e lartë. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë nga viti shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me punësimin e psikologëve dhe pedagogëve në arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës. Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetit Mytaher Haskuka.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, lidhur me pagesat e veteranëve të UÇK-së. Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Aida Dërguti i parashtrroi pyetje ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me zbatimin e marrëveshjes me Republikën e Shqipërisë për lejet e punës dhe për njohjen reciproke të së drejtës së pensioneve.
Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetes Aida Dërguti.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtrroi pyetje ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me aspektin e mbikëqyrjes së Agjencisë Kosovare të Privatizimit në fushën e respektimit të të drejtave të punëtorëve në ndërmarrjet shoqërore.
Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli i parashtrroi pyetje ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, në lidhje me padinë e kompanisë “Axos Capital” në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.
Ministri Blerand Stavileci nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtrroi pyetje ministres së Ministrisë së Drejtësisë, Dhurata Hoxha, lidhur me veprimet e kësaj ministrie kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
Ministrja Dhurata Hoxha nuk ishte e pranishme në sallë.

Deputetja Selville Halimi i parashtrroi pyetje ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me veprimet e kësaj ministrie për vendosjen e ujëmbledhësve nëpër rrugë.
Ministri Lutfi Zharku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rexhep Selimi i parashtrroi pyetje ministres Edita Tahiri në lidhje me bazën ligjore dhe mandatin për arritjen e marrëveshjes me Serbinë për targarat e automjeteve.
Ministrja Edita Tahiri iu përgjigj deputetit Rexhep Selimi.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 1 shtator 2016.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, Z. Arban Abrashi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin e lartëshënuar.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168 diskutuan: në emër të Komisionit për Buxheti dhe Financa, Naser Osmani, në emër të GP të PDK-së, Shukri Buja, në emër të GP të LDK-së, Naser Osmani, në emër të GP të LVV-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të AAK-së, Bali Muharremi, në emër të GP të LS, Slavko Simiq, në emër të GP Nisma, Valdete Bajrami, në emër të GP “6+”, Qerim Bajrami, si dhe

deputetët: Besim Beqaj dhe Faton Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----47,

Kundër ----- 7,

Abstenime ----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

1. Miratohet në parim Projektligji për nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin e lartshënuar.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës diskutuan: në emër të Komisionit Funkcional, Nait Hasani, në emër të GP të PDK-së, Nezir Çoçaj, në emër të GP të LDK-së, Salih Morina, GP të LVV-së, Mytaher Haskuka, GP të LS-së, Slavko Simiq, në emër të GP të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP Nisma, Shukrije Bytyqi, në emër të GP “6+”, Qerim Bajrami, si dhe deputetët: Shukri Buja, Bekim Haxhiu, Xhavit Haliti, Selville Halimi, Sabri Hamiti, Enver Hoti, Sala Berisha-Shala, Pal Leka, Mytaher Haskuka dhe Zafir Berisha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----71,

Kundër ----- 2,

Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-114 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Lidhur me raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015 diskutuan: në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sasha Milosavljeviq, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të GP të LDK-së, Blerim Grainca, GP të LVV-së, Faton Topalli, GP të LS-së, Sasha Milosavljeviq, në emër të GP të AAK-së, Pal Lekaj, në emër të GP Enver Hoti, në emër të GP “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Raif Qlaj, Visar Ymeri dhe Aida Dërguti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij raporti.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----52,
Kundër ----- 15,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

Miratohet raporti vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015.

7. Emërimi i një anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i ka shqyrtuar propozimet e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për emërim njërin nga kandidatët e propozuar.

Raportin e Komisionit Funksional për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e paraqiti dhe e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, znj. Albulena Haxhiu.

Kryetari e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarit të Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 56,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të nevojshëm për të vendosur për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie

Kryesusi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2016, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie.

Ai i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Kryetarët e grupeve parlamentare i propozuna deputetët për formimin e Komisionit ad hoc.

Kryesusi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie, në këtë përbërje:

1. Selviqe Halimi, nga GP i PDK-së, kryetare,
2. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së, zv/kryetar i parë,
3. Sasha Milosavleviq, nga GP LS, zv/kryetar i dytë,
4. Xhevahire Izroku, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Agim Kika, nga GP i LDK-së, anëtar,
7. Shqipe Pantina, nga GP i LVV-së, anëtare,

8. Zafir Berisha , nga GP Nisma për Kosovën, anëtar dhe
9. Danush Ademi, nga GP “6+”, anëtar.

II. Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Media duhet të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Medie dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 14 shtator 2016, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit, që deri në seancën plenare më 22 shtator 2016 t’i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ai i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t’i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryetarët e grupeve parlamentare i propozuna deputetët për formimin e Komisionit ad hoc.

Kryesusi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	65,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash

V E N D O S I

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Salih Morina nga GP i LDK-së, kryetar,
2. _____/_____, nga GP i LVV-së, zv/kryetar/e i/e parë,
3. Kujtim Paçaku, nga GP “6+”, zv/kryetar i dytë,
4. Selviqe Halimi, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Xhevahire Izmaku, nga GP i PDK-së, anëtare,
6. Doruntinë Maloku, nga GP i LDK-së, anëtare,
7. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. Bojan Mitiq, nga GP i LS-së, anëtar,
9. Zafir Berisha, nga GP Nisma për Kosovën, anëtar.

II. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, duhet t’i shqyrtojë dhe t’i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së, Grupi Parlamentar i LDK-së, Grupi Parlamentar i AAK-së kanë propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimet e grupeve parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri

V E N D O S I

I. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, deputetja Xhevahire Izmau emërohet kryetare e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të deputetit Zenun Pajaziti.

II. Nga Grupi Parlamentar i LDK-ës bëhet emërimi, si në vijim:

1. Deputetja Kimete Bytyçi emërohet anëtare në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Agim Kika,
2. Deputeti Agim Kika emërohet anëtar në Komisionin parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

III. Nga Grupi Parlamentar i AAK-së bëhet emërimi, si në vijim:

1. Deputeti Pal Lekaj emërohet anëtar në Komisionin për Punë të Jashtme,
2. Deputeti Lahi Brahimaj emërohet anëtar në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të deputetit Pal Lekaj,
3. Deputeti Ali Berisha emërohet anëtar në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Time Kadrijaj,
4. Deputetja Time Kadrijaj emërohet anëtare në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Lahi Brahimaj,
5. Deputeti Pal Lekaj emërohet anëtar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në vend të deputetes Donika Kada-Bujupi,
6. Deputeti Rustem Berisha emërohet anëtar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në vend të deputetit Pal Lekaj,
7. Deputeti Ali Berisha emërohet anëtar në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të deputetit Rustem Berisha.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 14:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale